



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr.961/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri kryesues Kymete Kicaj dhe Adnan Konoshevci anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Naim Qorri, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Glllogocit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Glllogocit, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.969/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Naim Qorri, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Glllogocit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Glllogocit, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërim të votave në Qendrat e Votimit QV 031X, QV 031E, QV 0318E, QV 0302E, QV 0321E, QV 0328E, QV 0327E.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.969/2021 të paraqitur nga Naim Qorri, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Glllogocit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Glllogocit me të cilën pretendon se në në Qendrat e Votimit QV 031X, QV 031E, QV 0318E, QV 0302E, QV 0321E, QV 0328E, QV 0327E se numri i votave që ka marrë nuk përputhet me numrin e votuesve të cilët e kanë votuar, andaj ka kërkuar nga PZAP që ta urdhëroj KQZ-në që të rinumroj fletëvotimet në këto Qendra të Votimit si në apel. Në mbështetje të pretendimeve të tij nuk ka paraqitur asnjë dëshmi si provë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtuar nga Naim Qorri, kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Glllogocit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në

Prishtinë, dega në Komunën e Gllogocit me të cilën kërkon rinumërim të votave në Qendrat e Votimit QV 031X, QV 031E, QV 0318E, QV 0302E, QV 0321E, QV 0328E, QV 0327E është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apeluesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

**Anr.961/2021 më datën 07.11.2021**



**Kryesuesi i Panelit**

**Zyheri Haziri**

***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.